



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2020:015576  
Datë: 29.02.2024  
Numri i dokumentit: 05391583

Ac.nr.183/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Hidajete Gashi Alaj dhe Faton Ademi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve I. A., K. H., K. M., L. R. T. dhe L. Q., të gjitha me banim në Shtime, që të gjitha me autorizim i përfaqëson L. B. avokat nga me seli në rr. “M.” në Hajvali, Komuna Prishtinë, kundër të paditurës Komuna Shtime, Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson L. M., për shkak të kompensimit të shpërblimit jubilar dhe kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.233/20, të datës 07.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Shtimes, Drejtoria Komunale për Arsim, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.233/20, i datës 07.10.2020, në pikën I dhe II (një dhe dy) të dispozitivit, në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë së paditësve K. M. dhe L. R. T. përkitazi me kompensimin e shpërblimit jubilar, ashtu që për këtë pjesë gjykohet si në vijim: REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve K. M. dhe L. R. T., me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Shtimes, Drejtoria Komunale për Arsim, që paditëses, në emër të shpërblimit jubilar për mbi 20 vite përvojë pune, paditëses K. M. t’ia kompensojë në vlerë të 75 % të pagës, shumën prej 303,75 € si dhe paditëses L. R. T. në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune, t’ia kompensojë në vlerë të 50 % të pagës, shumën prej 202,50 €.

II. REFUZOHET pjesërisht e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Shtimes, Drejtoria Komunale për Arsim, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.233/20, të datës 07.10.2020, në pikën I (një) dhe II (dy) të dispozitivit në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë së paditësve I. A., K. H., K. M., L. R. T. dhe L. Q. përkitazi me kompensimin për ushqim për ditët e pranisë në punë si dhe në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë së paditësve I. A., K. H. dhe L. Q. përkitazi me kompensimin për shpërblimin jubilar, si dhe pika III (tre) e dispozitivit, VËRTETOHEN.

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.233/20, të datës 07.10.2020, ndër të tjera ka vendosur si vijon: I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve: I. A., K. H., K. M., L. R.. T. dhe L. Q., të gjithë me banim në Shtime, si e bazuar. II. DETYROHET e paditura Komuna Shtime - Drejtoria e Arsimit, që paditësve I. A., K. H., K. M., L. R. dhe L. Q., të gjithë me banim në Shtime, në emër të shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit nga marrëdhënia e punës, t'ua paguaj shumat si në vijim: 1. Paditëses I. A. në emër të shpërblimit jubilar dhe ushqimit ditor për 532 ditë të pranisë së saj në punë - për periudhën 18.04.2017 deri 11.03.2020, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1,367.75 € (njëmijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro e shtatëdhjetë e pesë cent) dhe atë si në vijim: në emër të ushqimit për 532 ditë nga 2(dy) euro, shumën prej 1,064.00 € (njëmijë e gjashtëdhjetë e katër euro); në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune, në vlerë të 75% të pagës, shumën prej 303.75 € (treqind e tre euro e shtatëdhjetë e pesë cent). 2. Paditëses K. H. në emër të shpërblimit jubilar dhe ushqimit ditor për 529 ditë të pranisë së saj në punë - për periudhën 18.04.2017 deri 11.03.2020, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1,361.75 € (njëmijë e treqind e gjashtëdhjetë e një euro e shtatëdhjetë e pesë cent) dhe atë si në vijim: në emër të ushqimit për 529 ditë nga 2(dy)€ shumën prej 1,058.00 € (njëmijë e pesëdhjetë e tetë euro); në emër të shpërblimit jubilar për mbi 20 vite përvojë pune, në vlerë të 75% të pagës shumën prej 303.75 € (treqind e tre euro e shtatëdhjetë e pesë cent). 3. Paditëses K. M. në emër të shpërblimit jubilar dhe ushqimit ditor për 529 ditë të pranisë së saj në punë, për periudhën 18.04.2017 deri 11.03.2020, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1,361.75 € (njëmijë e treqind e gjashtëdhjetë e një euro e shtatëdhjetë e pesë cent) dhe atë si në vijim: në emër të ushqimit për 529 ditë nga 2(dy)€, shumën prej 1,058.00 € (njëmijë e pesëdhjetë e tetë euro); në emër të shpërblimit jubilar për mbi 20 vite përvojë pune, në vlerë të 75% të pagës shumën prej 303.75 € (treqind e tre euro e shtatëdhjetë e pesë cent). 4. Paditëses L. R. T. në emër të shpërblimit jubilar dhe ushqimit ditor për 533 ditë të pranisë së saj në punë - për periudhën 18.04.2017 deri 11.03.2020, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1,268.50 € (njëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë euro e pesëdhjetë cent) dhe atë si në vijim: në emër të ushqimit për 533 ditë pune nga 2(dy) euro, shumën prej 1,066.00 € (njëmijë e gjashtëdhjetë e gjashtë euro); në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune, në vlerë të 50% të pagës shumën prej 202.50 € (dyqind e dy euro e pesëdhjetë cent). 5. Paditëses L. Q. në emër të shpërblimit jubilar dhe ushqimit ditor për 393 ditë të pranisë së saj në punë - për periudhën 18.04.2017 deri 11.03.2020, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 988.50 € (nëntëqind e tetëdhjetë e tetë euro e pesëdhjetë cent) dhe atë si në vijim: në emër të ushqimit për 393 ditë pune nga 2(dy) euro, shumën prej 786.00 € (shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë euro); në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune, në vlerë të 50% të pagës shumën prej 202.50 € (dyqind e dy euro e pesëdhjetë cent). III. OBLIGOHET e paditura që paditëseve t'ua paguaj shumat e përcaktuar si në pjesën II të dispozitivit, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 777.60 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit të Kosovës që ankesën ta aprovojë si të bazuar ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë ashtu që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësve në tërësi si të pabazuar apo aktgjykimin e ankimuar ta anulojë dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Paditëset përmes të autorizuarit të tyre kanë paraqitur përgjigje në ankesë përmes së cilës i kanë kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të të paditurës, me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pathemeltë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet si dhe të detyrohet e paditura që t'ia paguajë paditëseve shpenzimet shtesë të procedurës në lartësi prej 624,00 € për përpilimin e përgjigjes në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 (pika e) dhe 200 (pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e të paditurës është pjesërisht e themeltë.*

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditëset I. A. K. H., K. M., L. R. T. dhe L. Q., të gjitha me banim në Shtime, kanë ushtruar padi për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe kompensimin në emër të ushqimit për ditët e pranisë në punë, kundër të paditurës Komuna e Shtimes, Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën kanë pretenduar se të njëjtat janë të punësuara tek e paditura, përkatësisht në SHFMU "E. D." në Prishtinë, dhe se në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit, të njëjtave u takon kompensimi për shpërblim jubilar dhe ushqim (*me detaje të tjera si në padi*).

Gjykata e shkallës së parë ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datë 21.09.2020 dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, pas dëgjimit të palëve në procedurë, administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.233/20, të datës 07.10.2020, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ndër të tjera ka theksuar se "nuk ishte kontestuese në mesë palëve ndërgjyqëse se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura nga data 18.04.2017 kur dhe ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive deri me datën 11.03.2020, kanë qenë në vendin e punës, respektivisht është vërtetuar prezenca e tyre në vendin e punës në ditët e precizuara për secilin veç e veç, nuk ishte kontestuese edhe lartësia e kërkesëpadisë por kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë se a u takojnë paditësve shumat e kërkuara. Gjykata me shiqimin e vërtetimeve për ditët në punë dhe përvojën e punës të paditësve lëshuar nga Drejtoria e SHFMU "E. D.", ka vërtetuar faktin e ditëve të pranisë të paditësve në vendin e punës nga data 18.04.2017, kur ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive deri me datën 11.03.2020 dhe atë paditësja I. A., për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 532 ditë, paditësja K. H., për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 529 ditë, paditësja K. M., për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 529 ditë, paditësja L. R. – T., në këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 533 ditë dhe paditësja L. Q. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 393 ditë.

Më tutje ka theksuar se sa i përket pagës jubilarë gjykata është bazuar në Kontratën Kolektive duke u bazuar në listën e përvojës së punës rezulton që paditësja I. A., ka përvojë pune 20 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën e që sipas kësaj kontrate për 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit i takon pjesa në vlerë të 75 % të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditëses është 405.00 €, siç vërtetohet përmes kontratës, i bije që në emër të pagës jubilarë paditëses i takon shuma prej 303.75€, paditësja K. H. ka përvojë pune 24 vite, e cila nuk ka qenë kontestues, për të paditurën ku 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit i takon shuma në vlerë të 75 % të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditëses është 405.00€, siç vërtetohet përmes kontratës, i bije që në emër të pagës jubilarë paditëses i takon shuma prej 303.75€, paditësja K. M., ka përvojë pune 25 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën ku 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të 75 % të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditëses është 405.00€, siç vërtetohet përmes kontratës, i bije që në emër të pagës jubilarë paditëses i takon shuma prej 303.75€, paditësja L. R., ka përvojë pune 15 vite, e cila nuk ka qenë kontestuese për të paditurën, ku 10 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit i takon shuma në vlerë të 50 % të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditëses është 405.00€, siç vërtetohet përmes kontratës, i bije që në emër të pagës jubilarë paditëses i takon shuma prej 202.50€ kurse paditësja L. Q., ka përvojë pune 12 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën, ku 10 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të 50 % të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditëses është 405.00€, siç vërtetohet përmes kontratës, i bije që në emër të 50 % pagës jubilarë paditëses, i takon shuma prej 202.50 €.”

Për mënyrën e vendosjes i është referuar dispozitave ligjore nga neni 35, paragrafi 7 dhe 8, pika 8.1 dhe 8.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë si dhe nenit 7 dhe 8 të LPK-së. Për shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 452, paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit pjesërisht e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, në pjesën vërtetuese, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, por gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e ka vërtetuar në mënyrë të gabuar, si dhe aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat arsye është dashur që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet sa i përket kërkesës së paditësve J. K. dhe I. I. për kompensim lidhur me shpërblimin jubilar.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 35 paragrafi 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 kur paditësve K. M. dhe L. R. T. u ka njohur të drejtën për kompensimin e shpërblimit jubilar, me të cilën dispozitë shprehimisht parashihet se *“Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i tyre i fundit, për 10 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 50% të një page bazë, për 20 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 75 % të një page bazë, për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë dhe për 40 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 150 % të një page bazë”*. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuari ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që i rezultoi se në rastin konkret paditëses K. M., e drejta për të kërkuar kompensimin e pagës jubilarë nga e paditura i ka takuar në vitin 2013, e kjo sipas Vërtetimit me nr.75/3, të datës 04.11.2019, lëshuar nga e paditura SHFMU “E. D.” në Prishtinë, nga i cili vërtetim rezultoi se paditësja ka gjithsej 26 (njëzet e gjashtë) vite përvojë pune ndërsa paditëses L. R., e drejta për të kërkuar kompensimin për shpërblim jubilar i ka lindur në vitin 2013, e kjo sipas Vërtetimit me nr.972, të datës 08.11.2019, lëshuar nga e paditura SHFMU “E. D.” në Prishtinë, nga i cili vërtetim rezultoi se paditësja ka gjithsej 16 (gjashtëmbëdhjetë) vite përvojë pune, mirëpo në periudhën kur paditëset e kanë mbushur jubileun, nuk ka pasur kontratë kolektive në fuqi, andaj nuk ka bazë ligjore për të kërkuar kompensim, pra në rastin konkret nuk është me rëndësi shumë periudha kur është kërkuar pasi çështje paraprake është se a ka pasur në fuqi kontratë kolektive në kohën e përmbushjes së kushtit për kompensim të pagës jubilarë. Meqenëse në vitin 2013 në kohën kur paditëset i kanë mbushur vitet jubilarë, ka munguar baza ligjore, kërkesëpadia e paditëseve është e pa bazuar, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata vendosi që të ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Në rastin konkret edhe sikur të ekzistonte baza ligjore për të kërkuar kompensim, pra sikur të kishte qenë në fuqi kontrata kolektive në vitin 2013, vit kur paditëset e kanë plotësuar kushtin pra përmbushja e jubileut, nga ajo kohë e deri në paraqitjen e padisë kanë kaluar më tepër se 3 vite sikurse përcaktohet me nenin 87 të Ligjit të Punës dhe padia e tillë është e paraqitur pas afatit ligjor. Prandaj, nga arsyet e theksuara gjykata ankimore duke vlerësuar se kërkesëpadia e paditësve për shpërblim jubilar nuk ka bazë ligjore, me referim në dispozitën e nenit 195, paragrafi 1 pika e), lidhur me nenin 201, paragrafi 1, pika d) të LPK-së vendosi që aktgjykimin në pjesën përkatëse ta ndryshoj me refuzimin e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit pasi që vlerëson se gjykata e shkallës së parë e ka konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, me nxjerrjen dhe administrimin e provave shkresore dhe mbi bazën e fakteve jo kontestuese si dhe provave të administruara dhe me të drejtë ka vendosur që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditëseve kur e ka obliguar të paditurën që në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve të pranisë në punë t’ua kompensojë shumat përkatëse të specifikuar si në dispozitiv të aktgjykimin e ankimuar. Kjo pasi që nga gjendja faktike e vërtetuar edhe kjo gjykatë me shikim në shkesa të lëndës vërtetoi se paditësja I. A. është e punësuar në SHFMU “E. D.” si mësimdhënëse, e kjo në bazë të kontratës me nr.05/116, e datës 14.01.2016 dhe e njëjta ka gjithsej 20 (njëzetë) vite përvojë pune, e kjo në bazë të vërtetimit 954, të datës 08.11.2019 dhe listës së pagave dhe e njëjta që nga viti 2016 e gjer më 11.03.2020 ka realizuar gjithsej 532 ditë mësimore. Paditësja K. H. është e punësuar në SHFMU “E. D.” si mësuese klase, e kjo në bazë të kontratës me nr.05/118, të datës 14.01.2016 dhe e njëjta ka gjithsej 22 (njëzetedy) vite përvojë pune, e kjo në bazë të vërtetimit 947, të datës 08.11.2019, 02/1078, të datës 13.11.2019 dhe 253/2014, të datës 17.04.2014 dhe listës së pagave dhe e njëjta që nga viti 2016 e gjer më 11.03.2020 ka realizuar gjithsej 529 ditë mësimore. Paditësja K. M. është e punësuar në SHFMU “E.D.” si arsimtare e lëndës gjuhë dhe letërsi shqipe, e kjo në bazë të kontratës me nr.05/119, e datës 14.01.2016 dhe e njëjta ka gjithsej 26 (njëzetegjashtë) vite përvojë pune, e kjo në bazë të vërtetimit 75/3, të datës 04.11.2019 dhe listës së pagave dhe e njëjta që nga viti 2016 e gjer më 11.03.2020 ka realizuar gjithsej 529 ditë mësimore. Paditësja L. R. T. është e punësuar në SHFMU “E.D.” si mësuese klase, e kjo në bazë të kontratës me nr.05/120, e datës 14.01.2016 dhe e njëjta ka gjithsej 16 (gjashtëmbëdhjetë) vite përvojë pune, e kjo në bazë të vërtetimit 972, të datës 08.11.2019 dhe listës së pagave dhe e njëjta që nga viti 2016 e gjer më 11.03.2020 ka

realizuar gjithsej 533 ditë mësimore. Paditësja L. Q. është e punësuar në SHFMU “E.D.” si mësimdhënës, e kjo në bazë të kontratës me nr.05/124, e datës 14.01.2016 dhe e njëjta ka gjithsej 12 (dymbëdhjetë) vite përvojë pune, e kjo në bazë të vërtetimit 111/3, të datës 13.11.2019 dhe listës së pagave dhe e njëjta që nga viti 2016 e gjer më 11.03.2020 ka realizuar gjithsej 393 ditë mësimore. Po ashtu lartësia e pagave është përcaktuar konform edhe listës së pagave bashkangjitur shkresave të lëndës për të gjitha paditëset.

Prandaj në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar dispozitat ligjore të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, përkatësisht nenin 35 paragrafi 7, të kësaj kontrate, në të cilin është paraparë se *“të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, 4 është 2 (dy) Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensim për ushqim”*.

Gjykata e Apelit vlerëson se pa dyshim kërkesëpadia e paditëseve është e bazuar dhe se po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*.

Nga ana tjetër, pretendimi të cilin e ka theksuar e paditura në ankesë se nuk ka buxhet për këtë lloj kompensimi për punëmarrësit e saj sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk qëndron pasi që në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë. Këto situata, eventualisht të disfavorshme për të paditurën nuk mund ti rregulloj as gjykata e as paditësja, si punëmarrëse, e po ashtu kontratat e përgjithshme kolektive mund të parashohin më shumë të drejta për punëmarrësit, përtej ligjeve në fuqi, por në asnjë mënyrë nuk mund të jenë më të disfavorshme për punëdhënësit duke paraparë më pak të drejta se ato që parashihen me ligjet në fuqi.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes i vlerësoi pretendimet tjera ankimore të së paditurës, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë me ndikim dhe peshë për një vendim ndryshe, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prandaj nga arsyet e theksuara gjykata ankimore vlerëson se kërkesëpadia e paditëses për shpërblim jubilar nuk ka bazë ligjore, me referim në dispozitën e nenit 195, paragrafi 1 pika e), lidhur me nenin 201 paragrafi 1, pika d) të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.183/2021, më datë 27.02.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,  
Besnik Bislimaj